

VENDIM
Nr.354, datë 13.6.2007

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT,
PARAUNIVERSITAR, SHKOLLËS SË MESME TË ORIENTUAR “PETER MAHRINGER”,
QË DO TË ZHVILLOJË MËSIMIN EDHE NË GJUHËN GJERMANE**

(ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 435, datë 22.6.2022)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e lejes për hapjen, në qytetin e Shkodrës, të institucionit arsimor privat, parauniversitar, *të shkollës së mesme të orientuar për teknologjinë e informacionit “Peter Mahringer”*, që do të zhvillojë mësimin edhe në gjuhën gjermane.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për të ndjekur zbatimin e dispozitave, ligjore e nënligjore, për arsimimin, edukimin dhe formimin në këtë institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha